



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Nr. _____ Prot

Korçë më, 10.11.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Date 10.11.2021

Drejtuar: *Shoqërisë “Almeta GMBH ”shpk adresa : Tiranë, Vorë, Marikaj, Autostrada Tiranë-Durrës, Marikaj.*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës **REF-08898-10-20-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **Blerje e 2 automjeteve zjarrfikëse**

Afati: **30 ditë kalendarike nga data e lidhjes te kontratës.**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 25.10.2021 Nr.154**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria “Almeta GMBH” shpk NIPT K22013001U me vleren:

7,990,000 (shtate milion e nenteqind e nentedhete mije) lekë, pa tvsh.

2. Shoqeria “Zeqiri” shpk, NIPT J67902827A me vleren:

9,780,000 (nente milion e shtateqind e tetedhete mije) lekë pa tvsh.

3. Shoqeria “Sparkle 32” shpk, NIPT L51327014R me vlerën:

8,800,000 (tetë milion e teteqind mijë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria “Zeqiri” shpk per arsye se:

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1.a, per arsye se ne formularin e vetdeklarimit sipas shtojces 8, ne piken A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, nuk jane shenuar te gjithë personat ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtorit ose mbikeqyresit, si aksioner ose si ortak, ka ose fuqi perfaqesuese, vendimarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik per te cilet ofertuesi duhet te deklaronte se nuk jane te denuar sipas parashikimeve te nenit 76 te LPP. Pra nuk eshte bere plotesimi i kesaj shtojce sipas kerkesave te saj dhe si rrjedhim autoriteti kontraktor nuk mund te beje verifikimet per gjendjen gjyqesore sipas parashikimeve te shkreses te perbashket te APP Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1Prot datë 01.02.2019

Konkretisht , nga verifikimi i bere ne Ekstraktin e Regjistrimit Tregetar te dorezuar nga shoqeria “Zeqiri” sh.p.k rezulton se pervec administratorit Z.Benjamin Lloshi , eshte edhe Z.Ardit Zeqiraj ne rolin e ortakut te vetem te shoqerise.

Ne deklaraten e dorezuar nga shoqeria “Zeqiri” sh.p.k shtojca 8, ne piken A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT ,eshte shenuar vetem Z.Benjamin Lloshi . Duke qene se Z.Ardit Zeqiraj eshte ortak ne kete shoqeri bazuar ne nenin 76 te LPP dhe bazuar ne kerkesat e shtojces 8 te Dokumentave te tenderit duhej qe ofertuesi te deklaronte edhe ortakun e kesaj shoqerie.

2. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti teknik, pika 2.2 ku percaktohet shprehimish se: “2.2.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .*”

Konkretisht ofertuesi ka paraqitur kontrate, vertetim, dhe fature per objektin ” Blerje makina transporti deri 12 ton” te realizuar me Bashkine Elbasan .

Per sa me siper KVO vlereson se kontrata e paraqitur nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit.

2. Shoqeria “Sparkle 32” per arsye se:

1.Oferta e paraqitur ne shtojcen 1 nuk perputhet me oferten e paraqitur ne shtojcen 2.

Konkretisht ne shtojcen 1 –Formulari i ofertes eshte shenuar:

“e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: ----- [10.621.364 (dhjetë milion e gjashtëqind e njezet e nje mijë e treqind e gjashtëdhjetë e kater)];

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [12.745.636.8(dymbëdhjet milion e shtatëqind e dyzet e pese mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pike tete)];

Ndersa ne shtojcen 2-Lista e cmimeve te artikujve eshte deklaruar:

Çmimi neto pa tvsh: 8.800.000 lek

Çmimi total me tvsh: 10.560.000 lek

Bazuar ne nenin 79 pika 4 te VKM Nr 285 dt 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” : *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ***Shoqërinë “ Almeta GMBH ” shpk me adresë: Tiranë, Vorë, Marikaj, Autostrada Tiranë-Durrës, Marikaj***, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 7,990,000 (*shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë)* lekë, ***pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.***

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**